

ANALIZË

Kurrikula e edukimit artistik në Kosovë

Nëntor 2015, Prishtinë



**FORUMI
KULTUROR**

Rrjeti i organizatave të pavarura

Rrjeti i organizatave të pavarura të
kulturës të Kosovës

www.forumikulturor.net



**FORUMI
KULTUROR**

Rrjeti i organizatave të pavarura të kulturës të Kosovës

Rrjeti i organizatave të pavarura të kulturës të Kosovës
www.forumikulturor.net

Prodhimi i këtij dokumenti është mundësuar me ndihmën e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, dhe Olof Palme Internacional Center e mbështetur nga Qeveria Suedeze.

“Ky publikim u prodhua me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Forumit Kulturor dhe në asnjë mënyrë nuk paraqet mendimet e Bashkimit Evropian”

ANALIZË

Kurrikula e edukimit artistik në Kosovë

Autore:

Besa Luzha



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë



SWEDEN

PËRMBAJTJE

HYRJE

RËNDËSIA DHE NATYRA E EDUKIMIT PËR INDIVIDIN DHE SHOQËRINË

ARTET SI PJSË E EDUKIMIT TË PËRGJITHSHËM

KURRIKULA SHKOLLORE DHE EDUKIMI ARTISTIK

QASJA METODIKE-DIDAKTIKE

EDUKIMI ARTISTIK NË KOSOVË

Vështrim i shkurtë retrospektiv

Periudha e mësimi parallel 1990-1999

Kurrikula e vitit 2000

Korniza Kurrikulare e mësimi parauniversitar në 2011

ARTET DHE EDUKIMI ARTISTIK NË KURRIKULËN E RE TË ARSIMIT

PARAUNIVERSITAR TË KOSOVËS

EDUKIMI ARTISTIK SUPLEMENTAR

PËRFUNDIM

REFERENCAT

FORUMI KULTUROR

HYRJJE

Kjo është një analizë e shkurtër e rolit dhe vendit që zë edukimi artistik në përgjithësi por edhe në kontekstin e Kosovës. Kurrikula e Re e Kosovës, si ajo për shkollimin e përgjithshëm ashtu edhe ajo për edukimin special artistik ofron mundësi shumë të mira për zhvillimin e shkathtësive artistike të nxënësve dhe aftësinë e tyre për përjetimin artistik. Megjithatë, probleme të mëdha në praktikën shkollore në Kosovë e pamundësojnë zbatimin e asaj që është e synuar përmes Kurrikulës. Me qëllim të krahasimit dhe pasurimit të analizës është krahasuar edhe roli i artit dhe edukimit artistik edhe në Kurrikulat Kombëtare të vendeve të ndryshme Evropiane. Një vështrim i shkurtër retrospektiv i është bërë edukimit artistik në Kosovë edhe në vitet e kaluara, për të analizuar progresin dhe ndryshimet duke e ditur se edukimi në përgjithësi është i varur nga zhvillimet shoqërore në përgjithësi.

dime konkrete për institucionet relevante se si mund të rritet cilësia e edukimit artistik në kuadër të arsimit të përgjithshëm formal por edhe format e tjera jo-formale që mund të ndihmojnë zhvillimin e qëndrimit pozitiv dhe dashurisë ndaj artit si veprimtari shoqërore por edhe zhvillimin e shkathtësive të ndryshme artistike të nxënësve që e pasurojnë personalitetin e tyre ose edhe që e orientojnë më tutje për karrierë në këtë veprimtari.

Në fund janë dhënë rekoman-

RËNDËSIA DHE NATYRA E EDUKIMIT PËR INDIVIDIN DHE SHOQËRINË

Zhvillimi i hovshëm i shkencës dhe i teknologjisë në vazhdimësi ka ballafaquar njerëzimin me sfida të reja në të gjitha fushat e krijimtarisë njerëzore dhe veçanërisht në sferën e arsimit (edukimit), sepse ky zhvillim në njërin anë dhe arsimit (edukimit) në anën tjetër, janë nxitje e njëri tjetrit në raport reciprok. (Popovich, 2009; Bresler, 1993; Miller, 2000; Freedman & Stuhr, 2004).

Qëllimet dhe objektivat e edukimit dhe të arsimit si një fenomen kompleks dhe ndërveprues ndryshojnë vazhdimisht krahas me ndryshimin e rrethanave shoqërore. Edukimi dhe arsimimi, si dy anë të një fenomeni, të cilat bashkëveprojnë të ndërlidhura dhe të pandara, kanë një funksion të vetëm në gjithë historinë e zhvillimit të shoqërisë: bartjen dhe çuarjen më tej të përvojave, të njohurive, të shkathtësive, të sjelljeve dhe të qëndrimeve nga një gjeneratë në tjetrën dhe pajisjen e individit me njohuri, shkathtësi, qëndrime e vlera të lidhura me aktualitetin shoqëror të kohës. Ky funksion është realizuar në faza të ndryshme të zhvillimit të shoqërisë, duke pasur përherë një synim, përparimin dhe transformimin e shoqërisë. Kërkesa për këtë ka qenë në vazhdimësi shtytje për zhvillimin dhe

përparimin e njohurive dhe shkathtësive në veprimtaritë kryesore të njerëzimit si në arsim, shkencë, art dhe në kulturë.

Edukimi është faktor determinues i zhvillimit të shoqërisë, prandaj në procesin edukativ duhet të përfshihen zhvillimet aktuale ekzistuese në shoqëri, por edhe të kultivohen vlerat pozitive të traditës, si dhe të përfshihet vizioni për të ardhmen. Aktualiteti ka kuptimin që ata që marrin pjesë në procesin edukativ, të mos kenë përfunduar duke marrë njohuri e informacione të cilat nuk janë aktuale dhe që nuk mund të aplikohen në jetën dhe në veprimtarinë e tyre të mëtejshme. Me një fjalë, procesi edukativ - arsimor duhet të zhvillojë aftësitë, shkathtësitë dhe mekanizmat e përshtatjes ndaj ndryshimeve dhe zhvillimeve në të gjitha veprimtaritë njerëzore, si në ato shkencore ashtu edhe në ato artistike.

UNESCO (Organizata e Kombeve të Bashkuara për Edukim, Shkencë dhe Kulturë) e thekson këtë në dokumentin e saj më të fundit "Rethin-

ing Education-Toëards a Globbal Common Good”(Rishikimi i Edukim-it-Drejt një të mire të përbashkët globale”:

Bota po ndryshon-edukimi duhet të ndryshojë poashtu. Shoqëritë janë duke u transformuar dhe kjoë thërret për forma të reja të edukimit që zhvillojnë kompetenca që shoqëritë dhe ekonomitë kanë nevojë sot dhe nesër. Kjo do të thotë përtej shkim leximit dhe numrave, duhet të fokusohemi në ambiente të të nxëniet dhe qasje të reja për drejtësi më të madhe, barazi sociale dhe solidaritet global. Edukimi duhet të jetë se si të jetojmë në këtë planet nën trysni. Duhet të jetë për edukimin kulturor, në baze të respektit dhe dinjitetit të barabartë, duke ndihmuar dimensionet sociale, ekonomike dhe të ambientit në kuadër të zhvillimit të qëndrueshëm(UNESCO, 2015,f3)

Edukimi dhe arsimimi po ash-tu duhet të jenë faktorë ndikues në demokratizimin e shoqërisë në kuptim të respektimit të dallimeve, lloj-llojshmërisë dhe diversitetit në çdo aspekt. Kulturat e ndryshme, histo-

ria dhe të arriturat e reja të njerëzimit, shikuar në mënyrë globale, duhet të gjejnë vend në procesin edukativ-arsimor krahas aftësimit të nxënësve për shkathtësitë e ndryshme jetësore. Synimi i edukimit të sotëm do të jetë pikërisht aftësimi i individit për t’u përballur me këto ndryshime, që rrjedhin nga marrëdhëniet e reja shoqërore, politike e kulturore, të projektuara në një shoqëri.

Demokratizimi i shoqërisë nënkupton në radhë të parë krijimin e raporteve më humane në shoqëri dhe sipas Malliarët (1997, f.59) “nënkupton marrjen në konsideratë të vlerave individuale të shoqërisë në unitet dialektik“. Sipas kësaj, respektimi i individit dhe potencialit të tij për zhvillimin dhe funksionimin e shoqërisë, është kusht i domosdoshëm për të realizuar “demokratizimin” në arsim dhe jo vetëm ofrimi i procesit edukativ arsimor për të gjithë nxënësit pa dallim Në kushtet e zhvillimeve të reja shoqërore politike dhe ekonomike, me një ekonomi të tregut, të pro-

ceseve integruese e globalizuese, qëllimi kryesor i arsimimit/edukimit në kohën e sotme ka ndryshuar dhe evoluar nga qëllimi i krijimit të një personaliteti harmonik të zhvilluar nga të gjitha aspektet, në drejtim të synimit për „favorizimin sa më të plotë të sjelljeve të çdo njeriu ...si qenie individuale dhe pjesëtar i një shoqërie ku mbretëron solidariteti.“¹

Aspekti i solidaritetit është trajtuar shumë më herët në këtë kontekst, që kur dy sociologët e shquar Emil Durkheim (1857-1917) dhe Talcot Parsons (1902-1979) të njohur si përfaqësues të botëkuptimit funksionalist kanë diktuar dhe argumentuar se solidariteti shoqëror është një vlerë e rëndësishme për shoqërinë andaj rrjedhimisht edukimi do të duhej të synojë zhvillimin e kësaj vlere për ti bashkuar njerëzit në shoqëri. Parson theksonte në vecanti rolin e solidaritetit brenda familjes dhe dallimin e vecorive individuale si vlera të cilat do të duhej të zhvilloheshin përmes edukimit. Është i njohur koncepti i tij i “role al-

location” (përcaktimi i rolit) në bazë të aftësive dhe talenteve individuale të cilat do të diktonin profesionet e secilit individ në të ardhmen.

Aktualisht, procesi i edukimit është karakterizuar me një tendencë të përqëndrimit në zhvillimin e vetëm disa aftësive apo të shkathtësive kryesore të konsideruara të rëndësishme për tregun e punësi (leximi, matematika, teknologjia, ndërmarrësia, komunikimi dhe te shprehurit etj). Poashtu, është vërejtur një lloj manie për standardizim, matje njohurish dhe testim shkathtësishë apo edhe uniformim të këtyre arritjeve apo shkathtësive në dëm të një edukimi më të tërësishëm (holistik) dhe shpirtëror të synuar më herët

Beteja në mes lëndëve të ndryshme mësimore për të zënë vend qendor në kurrikulën shkollore është zhvilluar prej se ekziston shkolla si institucion dhe arsimi si veprimtari shoqërore dhe kjo betejë po vazhdon edhe në ditët e sotme. Fokusi në shkathtësi “për

¹ Poaty, f.10

jetë” apo biznesore, dhe përgaditja për tregun e punës, vazhdimisht po ndikon që shkollimi të përqëndrohet në trajtimin e nxënësve vetëm si punëtorë të ardhshëm të profileve të ndryshme, pa l kush-tuar kujdes edhe aspekteve të tjera që e përmbushin jetën e njeriut si, letërsia, arti, kultura, filozofia dhe disiplina të tjera që do të duhej të mësonin nxënësin për botëkuptimet e ndryshme për jetën, njerëzimin, pse jo edhe moralin, estetikën, etikën etj. Si pasojë, gjithandejt nëpër botë, arti dhe kultura janë zakonisht të lëna në margjina dhe u jepet kohe dhe burime të mjaftueshme vetëm në raste të pakta, e zakonisht pasi të jenë shterrur burimet kohore, financiare dhe kadrovike për të gjitha lëndet tjera në shkollë.

Si pasojë e kësaj qasje, John P. Miller(2000) argumenton se edukimi i kohës së sotme po e trajton individin si maqinë, dhe prandaj edhe sistemi arsimor po implementon qasje teknike/teknologjike ndaj nxënësve, duke u fokusuar në procese, procedura, veprime rutinore andaj ai e thekson vërejtjen

nga një studiues tjetër Sardello, Robert (1992) që thekson se:

Edukimi, ndërkaq, është bërë institucion qëllimi i të cilit në botën moderne nuk është të prodhojë kulturë, e as ti shërbejë botoës së gjallë, por të ndërlidhë njerëzimin vetëm me forcat vdekjeprurëse të materializmit. Edukimi, sic e dimë ne, prej nivelit parashkollor e deri të shkollimi i lartë, po e dëmton shpirtin (fq 50).

Për këtë arsye Miller (2000) kërkon që në shkolla të praktikohen edhe forma apo strategji të vecanta të edukimit si “vizualizimi” ose “imagjinimi i udhëzuar” (“guided imaginary”) dhe meditimi, ditari reflektues e forma të tjera që ai mendon se do të arrijnë të edukojnë shpirtin e individit.

Në anën tjetër, UNESCO-s (Organizata e Kombeve të Bashkuara për Shencë dhe Kulturë) poashtu e sheh më gjerë rolin e edukimit. Sipas tyre:

Roli i edukimit duhet të jetë fuqizimi i fëmijëve dhe të rriturve për tu bërë pjesëmarrës aktivë në transformim-

in e shoqërove të tyre. Nxënia/(mësimi) duhet të fokusohet edhe në vlera, qëndrime dhe sjellje(veprime) që mundësojnë individivë të mësojë të jetojë së bashku në një botë të karakterizuar nga diversiteti dhe pluralism (UNESCO, 2016).

Rrjedhimisht, ekspertët e arsimit bashkëkohor sot në përgjithësi dakordohen se roli i edukimit në shoqërinë bashkëkohore është që tu ofrohet nxënësve mundësia të zhvillojnë shkathtësi që i përgadisnin për jetë në aspektin fizik, intelektual por edhe atë shpirtëror. Në këtë kontekst, edukimi artistik apo edukimi përmes lëndëve artistike shihet si mundësi që të ndikojë më tepër në këtë aspekt të zhvillimit.

Si konkludim, esenca e edukimit bashkëkohor sot qëndron në zhvillimin e aftësisë së të menduarit kritik të nxënësit, në zhvillimin sa më të plotë psikofizik, emocional, intelektual dhe social të tij, që arrihet vetëm kur nxënësi me të vërtetë është subjekt (aktiv) i këtij procesi ndërveprues dhe jo objekt pasiv i tij.

Nxënësit duhet të edukohen dhe arsimohen në atë mënyrë që të jenë të lirë në shprehje, të zhvillojnë gjykimin e drejtë për gjërat që na rrethojnë dhe në të njëjtën kohë të zhvillojnë aftësinë për kreativitet, sepse ajo është forca që e çon njerëzimin përpara. Në këtë kuadër mësimdhënia bashkëkohore synon të jetë një bashkëbisedim mes dy partnerëve-mësimdhënësit dhe mësim-marrësit, dhe detyrë e të parit është që ky bashkëbisedim t'i përshtatet moshës, aftësisë perceptuese të nxënësit por njëkohësisht të jetë i bazuar në të vërtetën shkencore.

Kjo qasje kërkon një aftësim dhe përgatitje profesionale – pedagogjike të mësimdhënësit si nxitës dhe udhëheqës i këtij procesi si dhe një qasje krejtësisht tjetër ndaj procesit edukativ-mësimor. Duke e analizuar mësimdhënien dhe mësimnxënien si aktivitete konkrete të fenomenit të edukimit në dritën e zhvillimeve aktuale, vizioni për të ardhmen duket i qartë: duhet bërë përpjekje të vazhdueshme për aftësim profesional

të kuadrove në profilet e ndryshme arsimore, artistike e shkencore të nevojshme për zhvillimin dhe përparimin e tërësishëm të njeriut dhe të shoqërisë duke mos anashkaluar zhvillimin e vlerave dhe të qëndrimeve pozitive të individit si pjesë e familjes, komunitetit, shoqërisë dhe botës globale. Prandaj, në këtë kontekst mund të radhisim synimet e edukimit bashkëkohor si vijon:

- Aftësimi për të menduarit, të kuptuarit dhe të reflektuarit rreth dukurive dhe fenomeneve brenda ambientit që na rrethojnë me qasje individuale dhe kritike;
- zhvillimi i aftësive psikofizike që i disponojnë në kuptim të favorizimit të interesave të tyre;
- pasurimi i botës shpirtërore dhe emocionale përmes aftësimit për përjetim, njohje dhe vlerësim të vlerave pozitive artistike e kulturore;
- identifikimi dhe përparimi i potencialit krijues (i dispozitave krijuese);
- fitimi i njohurive, informacioneve dhe transformimi i tyre në shkathësi që do të përdoren në kontekste të ndryshme jetësore;

- zhvillimi i qëndrimeve, sjelljeve dhe i bindjeve ndaj fenomeneve e dukurive dhe ndaj vlerave pozitive shoqërore;
- motivimi për mësim të vazhdueshëm, për përparim të vetvetes dhe të shoqërisë;

Këto synime duhet të kuptohen si përgatitje sa më e plotë e nxënësit për t'iu përshtatur jetës, progresit dhe ndryshimeve, vështirësive dhe sfidave krahas zhvillimit të tij fizik, intelektual, shoqëror dhe emocional.

Në gjithë këtë kompleks përpjekjesh drejt këtyre synimeve, edukimi artistik pa dyshim se ka rolin e tij të veçantë, sidomos në fushën emocionale dhe në formimin estetik e kulturor të personalitetit në formim.

ARTET SI PJESË E EDUKIMIT TË PËRGJITHSHËM

Në të kaluarën besohej se arti ishte diçka që ishte më e organizuar se vetë jeta, si diçka që e kërkonim si prehje (ikje) nga jeta. Ndryshimet që kanë ndodhur në këtë shekull, janë të tilla që arti më nuk shihet si ikje nga jeta por më tepër si kthim dhe afrim kah ajo. (John Cage, kompozitor)

Arti është formë e veçantë e të shprehurit dhe e krijimtarisë njerëzore dhe si e tillë ka qenë dhe është vazhdimisht objekt i analizave dhe i studimeve, duke synuar të depërtohet thellë në natyrën dhe në vlerën në radhë të parë, por edhe për të shpjeguar rolin apo funksionin që arti ka në shoqëri. Zgjerimi i horizontit të diturive mbi botën, jetën dhe njeriun, padyshim përshkon edhe artin, prandaj roli i tij në shoqërinë bashkëkohore është i madh.

Vlerësohet se arti duke qenë fenomen edhe shoqëror, ndikon në mënyrë të shumanshme, duke e zhvilluar vetë njeriun dhe shoqërinë. Shpesh arti dhe është konsideruar gjithnjë si një shtegtim në një botë tjetër, larg nga realiteti. Forcë

shtytëse e këtij“ shtegtimi“ ka qenë imagjinata e njeriut. Por, duke qenë se koha e sotme karakterizohet me një zhvillim të hovshëm të shkencës dhe të teknologjisë, ne me të vërtetë mund të konsiderojmë se sot arti na mban në „shtegun „ e jetës reale njerëzore me, përjetimet, emocionet, ndjenjat dhe gjithçka tjetër që simbolizon njerëzoren.

Siç është e njohur, që në kohët më të lashta ka ekzistuar dëshira e njeriut për të krijuar diçka të re. Ajo diçka duhet të ishte e dobishme për vetë individin , por edhe për të tjerët. Vetë procesi i krijimit të mjeteve të punës ishte diçka më tepër se proces i punës me qëllim të dobisë materiale.

Në zanafillën e tij arti është manifestuar në ceremonitë e ndryshme, nëpërmjet të riteve e ceremonive dhe në formë sinkretike janë kombinuar muzika, lëvizja, gjestet, fjalët, ngjyrat ,etj. Duke e zhvilluar ndjenjën për ngjyrë, për fjalët e bukura, për gjestet , ritmin, tingujt, njeriu i ka shfrytëzuar këto për të pasuruar

jetën e tij dhe për të shprehur përjetimet, shqetësimet, përfytyrimet mbi jetën dhe botën.

Nga kjo paraqitje e sintetizuar secila formë e të shprehurit dhe e krijimtarisë njerëzore ka marrë rrugën e vet dhe është zhvilluar në veçanti, duke u zhvilluar dhe modifikuar vazhdimisht. Sot Arti dhe shkenca janë dy fusha të gjera të krijimtarisë dhe të të arriturave të njerëzimit, të pasuruara, të diferencuara por që përsëri bashkëveprojnë me njëra tjetrën, duke u plotësuar, duke dhënë dhe marrë nga njëra tjetra. Shkenca dhe teknologjia zhvillojnë shoqërinë në aspektin material dhe praktik, në këtë kontekst zhvillon edhe vetë artin, përmes avancimit të mundësisë së përjetimit të tij, përmes zhvillimit dhe përsosjes së mjeteve për krijimin, transmetimin dhe ruajtjen e vlerave artistike, kurse arti zhvillon botën shpirtërore të njeriut dhe humanizon jetën, i jep imagjinatë dhe bukuri mendjes së ndritur, shtytje dhe forcë njerëzimit, për t`u zhvilluar më tutje

në çdo aspekt. Tanimë çdo inovacion në shkencë dhe në teknologji është i paimagjinueshëm që të ketë sukses pa përmbajtur formë dhe vlerë artistike.

Arti ka funksione të shumëfishta në shoqërinë njerëzore. Për ne është veçanërisht i rëndësishëm funksioni edukativ i artit, i cili shprehet pikërisht duke pasur forcë të jashtëzakonshme ndikuese në vetëdijen dhe nënvetëdijen e njeriut, në emocionet, ndjenjat mendimet dhe karakterin e tij. Prandaj dhe Eisner (2002) nënvizon se parimet e funksionimit të artit mund të jenë shumë efektive kur përdoren në edukim.

Kështu ka qenë që në zanafillën e tij .Pikërisht në ceremonitë, ritualet fisnore e festat e ndryshme, të përkushtuara kulteve dhe besimeve, ne mund të gjejmë zanafillat e formave të para të shfaqurit të krijimtarisë artistike dhe njëherësh momentin kur paraqitet nevoja për t'u vazhduar, bartur, transmetuar kjo krijimtari dhe kjo pasuri shpirtërore të gjeneratat e reja. Këtu mund të

identifikohet zanafilla e paraqitjes së nevojës për edukim përmes artit.

Kerry Freedman dhe Patricia Stuhr (2004) theksojnë se nëse roli i edukimi është që nxënësit të përgatisë nxënësit për vetëpërbushje (self fulfillment) dhe që ata të kontribuojnë në mënyrë konstruktive në shoqëri, edukimi artistik duhet të shkojë përtej mësimi përmes disiplinës dhe standardeve dhe të mësojnë për jetën përmes artit. Edhe pse këta dy studjues fokusohen posaçërisht në artet pamore, kjo qasje i përshtatet në përgjithësi edukimit artistik.

Në nivelin Evropian, edukimit artistik dhe kulturor i është dhënë rëndësi e veçantë. Strategjia e EU për bashkëpunim në edukim dhe arsimim (trajnim) pati theksuar rëndësinë e kompetencave transversal, sic janë vetëdijësimi kulturor dhe kreativiteti, duke e shpallur vitin 2009, si vit të Kreativitetit, kurse poashtu më 2009 u kalua edhe Rezoluta për Studimet Artistike në Parlamentin Evropian. Për të kontribuar

synimeve të vendosura, ishte zhvilluar edhe një studim krahasimor për qëllimet, objektivat dhe mënyrën e organizimit të edukimit artistik në të gjitha vendet e Evropës.²

Të gjeturat kryesore të këtij studimi janë:

a) qëllimet e edukimit artistik-janë pothuajse të njëjta ose të ngjashme në gjithë Evropën. Ato përfshijnë: shkathtësitë artistike, cmuarjen e artit, njohjen dhe të kuptuarit, të shprehurit artistik etj.

b) Ndërlidhja e artit me lëndët e tjera: Zakonisht artet mendohet të kontribuojnë në zhvillimin e shkathëtsive ose kompetencave të përgjithshme (komunikimi, socializimi, etj)

c) kompetencat artistike janë të synuara në shumicën e vendeve. (Shih fig. 1, Euridice)

d)

e)

Mënyra e organizimit në kurrikula: Në vende të ndryshme artet trajtohen ndryshe brenda kurrikulës shkollore. Diku janë pjesë e obligueshme, e diku ofrohen si mësim zgjedhor. Diku ato ofrohen në formë interdisiplinare brenda fushës kurrikulare artet, e diku janë të ndara lëndët Muzikë, Dramë, Vallëzim, Arte Vizuele dhe Punë dore (Crafts) apo Dizajn përfshirë edhe teknologjinë bashkëkohore përmes kurseve për Fotografi, Film etj që janë megjithatë më pak të pranishme dhe kryesisht vetëm në vendet shumë të zhvilluara.

² http://eacea.ec.europa.eu/education/eurydice/documents/thematic_reports/113en.pdf

KURRIKULA SHKOLLORE DHE EDUKIMI ARTISTIK – QASJA METODIKE-DIDAKTIKE

Kryesisht në shumë vende të Evropës format kryesore të artit që janë si lëndë të obligueshme janë: Artet pamore, Muzika, Punëdore. Të tjerat si Drama, Media, arkitektura, vallezimi etj ofrohen në forma të tjera alternative si mësim zgjedhor me autonomi të shkollës në përcaktimin e statusit dhe të kohës së alokuar.

Artet megjithatë janë pjesë e kurrikulës shkollore ku më pak e ku më shumë, duke tentuar të zhvillojnë shkathtësitë artistike të nxënësve krahas elementeve të edukimit estetik për të përjetuar vlerat artistike.

Lora Bresler, nje studiuese e shquar e edukimit artistik konstaton tre qasje kryesore te edukimit artistik në kurrikulën shkollore gjatë punës së saj hulumtuese përmes observimit të mësimit të arteve në shkollë:

Orientimi i Intervenimeve të vogla (The Little-Intervention Orientation)

Kurrikula e Orientuar nga Produkti (Krijimi) Artistik (The Production-Oriented Curriculum)

Orientimi I Explorimit të udhëhequr (udhëzuar) /The Guided-Exploration Orientation

Duke analizuar të tre këto qasje përmes hulumtimeve të shumta në praktikën shkollore, Bresler thekson se vetëm qasja e tretë, explorimi i udhëhequr nga mesimdhënesit eksperte e te pergaditur mundëson edukimin efektiv artistik ose per-

mes artit, por veteëm ne kushtet kur edhe ambienti është estetik dhe mësimdhënësit janë artistikisht perceptues në një klimë kulturore që nxit prodhimin dhe cmuarjen e vlerave artistike. Praktika, sic thotë ajo dëshmon të kundërtën, se ambienti në përgjithësi është jo-estetik, me pak kohë rezervuar për arte dhe me numër të pakët të specialistëve të artit në shkolla. Sipas saj modeli i eksplorimit të udhëhequr mundëson ndërlidhjen e ngushtë në mes të gjithë komponenteve kryesore të edukimit artistik: zhvillimin konceptual, shkathtësitë, njohuritë dhe kreativitetin si aftësi e vecantë.

Reforma e kurrikules së edukimit artistik është duke synuar të arrijë të theksojë rëndësinë e kultivimit të përvojës kritike dhe të menduarit nga perspektiva e elementeve artistike (textura, ritmi, ngjyra, dizajni, koha dhe hapësira) përmes zhvillimit të fjalorit me të cilin nxënësit do të dinë t'i artikulojnë këto perceptime, e deri te aktivitetet që lejojnë nxënësit të zhvillojnë përvoja të reja

në këtë drejtim. Bresler shpjegon se nje kurrikulum i tille do të theksonte më shumë mësimdhënien e shkathtësive estetike (observim, vizatim, dëgjim, krijim dhe levizje aktive e intelektuale dhe aktivitete ku stimulohet cmuarja e artit dhe historisë së artit përmes kryeveprave nga e kaluara.

Kjo qasje që pothuajse mbretëron në të gjitha vendet e ndryshme të botës, është aplikuar edhe gjatë reformimit të kurrikulës për edukimin artistik në sistemin arsimor të Kosovës, gjatë rishikimit të fundit më 2011.

Para se të adresojmë konkretisht këto aspekte ne kurrikulën e re, mendojmë se është e vlefshme për lexuesin të bëjme një vështrim retrospektiv se si është zhvilluar edukimi artistik në Kosovë në të kaluarën.

EDUKIMI ARTISTIK NË KOSOVË

Vështrim i shkurtë retrospektiv

Që nga fillimi i themelimit të sistemit të rregullt arsimor në Kosovë, në vitin 1945, si pjesë e sistemit të atëhershëm arsimor të Serbisë e pastaj edhe të Jugosllavisë, lëndët artistike kanë qenë kryesisht në shërbim të ideologjisë së asaj kohe-socializmit dhe përmes lëndës Edukatë Muzikore dhe Edukatë figurative janë nxitur nxënësit që talentin e tyre për muzikë ose shprehje figurative ta vënë në funksion të ndërtimit të një identiteti të përbashkët Jugosllav, për vetëqeverisjen, sukseset e shtetit e të Partisë, idenë e vëllazërim bashkimit në mes të gjithë qytetarëve etj.

Natyrisht, këto dy lëndë kanë mundësuar edhe arsimimin artistik Brenda disiplinës, pra mësimin e shkrim leximit muzikor, aftësisë për këndim, dëgjim muzike, luajtje në instrument si dhe aftësinë për tu shprehur me ngjyra, forma dy e tre dimensionale etj. Element i rëndësishëm i edukimit artistik në shkollë ka qenë edhe njohja e krjiuesve, in-

terpretëve e artistëve të fushave të ndryshme nga të gjitha viset e shtetit Jugosllav.

Qytetarët e Kosovës, kanë mundur të mësojnë për krijuesit vendor nga Kosova dhe patjetër për të tjerët nga viset e tjera të Jugosllavisë, por jo edhe për krijuesit e shquar shqiptarë që kanë jetuar dhe vepruar në Shqipëri. Kjo tendencë për asimilimin e ndjenjës kombëtare përmes arteve është refuzuar nga ekspertët e arsimit në Kosovë duke mos e pranuar procesin reformues të njohur si “bërthamat e përbashkëta” në vitet 1980-1990. Autorja e këtij punimi ka bërë një analizë për këtë ndikim ideologjik-politik në fushën e edukimit muzikor gjatë kësaj periudhe (Luzha, 2008) por procesi ngjashëm është realizuar edhe me fushën e arteve pamore, letërsinë, dramën etj.

Përpos këtyre limitimeve, lëndët artistike në shkollë, në kuadër të këtij sistemi kanë qenë shumë më të vlerësuara në shkollë. Aktivitetet shkollore muzikore, ekspozitat,

garat e ndryshme artistike kanë qenë motivuese për nxënësit që të zhvillojnë prirjet e tyre krijuese në fushat e ndryshme artistike. Duke qenë vetë personalisht dëshmitare e kësaj periudhe si nxënëse e klasës 5-8, gjatë viteve 1981-1985, mund të rikujtoj punë të shumta artistike brenda artit pamor (tapiseri, vitrazh, mozaik, picture, etj) dhe pjesëmarrjen në orkestër shkollor të melodikave, blokflautave, anëtare e korit të Shkollës dhe pjesë e instrumentistëve të shkollës. Garat krahinore, republikane e federative për koret shkollore kanë qenë festivali vërtetë i muzikës korale shkollore, ndonëse sic u tha më sipër këngët kanë qenë kryesisht me tematikë të ndikuara nga ideologjia e kohës.

Në shkolla ka ekzistuar grupi i dramës, grupi i recitatorëve të shkollës, klubi i shkrimtarëve të rinj, grupet e vallezimit popullor por dhe të kohës, etj. Shkollat janë krenuar me numrin e madh të aktiviteteve artistike dhe rezultatet e arritura në këto veprimtari.

Periudha e mësimit paralel 1990-1999

Në këto kohë të vështira kur mësimi në gjuhën shqipe në Kosovë u zhvillua në kushte improvizimi, nëpër shtëpi-shkolla (Summers & Buckland, 2004), arti kryesisht luante rolin e kultivimit të ndjenjës kombëtare si antagonist ndaj shtypjes që i bëhej nga regjimi i asaj kohe. Në këtë periudhë nuk kishte kushte për ekspozita, punë të paruar artistike dhe mundësi për përjetim të veprave artistike por lëndët artistike. Në orët e Edukatës muzikore dhe asaj figurative që rrallëherë mbaheshin të rregullta, nën ndikimin e ideologjisë së re, atdashedurisë dhe identitetit kombëtar, nxënësit në kushte modeste përdornin format e shprehjes artistike për të shprehur shqetësimet e tyre të kohës, luftën, vuajtjet, dëbimin masiv dhe dëshirën për liri. (Republika e Kosovës, 1995).

Kurrikula e vitit 2000

Në vitin 2000 Institucionet e Kosovës, bashkë me UNMIKUN që bashkëqeverisnin vendin në këtë periudhë nisën një reformë të gjithanshme të edukimit dhe arsimit në Kosovë. Ndryshime pësoi edhe sistemi nga ai fillor 8 vjecar në një sistem 9 vjecar të ndarë në dy nivele-Shkollimi fillor (I-V) dhe Shkollimi i mesëm i ultë (VI-IX). Kurrikula e re e Kosovës adaptoi një qasje të re ndaj edukimit dhe arsimit, duke trajtuar fushat kurrikulare dhe duke i përditësuar përmbajtjet mësimore nëpër lëndët e ndryshme mësimore. Si qasje, u trajtua si shumë positive, edhe gjatë analizës që i bëri Instituti i Edukimit nga Universiteti i Londrës (Peffer et al, 2005). Por analiza theksoi se implementimi do të jetë i vështirë meqë mësimdhënësit janë të përgaditur ndryshe dhe do të kishin vështirësi derisa të trajtoheshin të gjithë mësimdhënësit për ta zbatuar kurrikulën e re. Megjithatë pati ndryshime positive, tekstet pak a shumë

u liruan nga përmbajtjet ideologjike të të kaluarës, u tentua që të nxitet zhvillimi i shkathtësive artistike të nxënësve dhe të zgjerohet horizonti i njohurive të nxënësve për artin, kulturën në përgjithësi por edhe atë kombëtare në vecanti. Megjithatë ndërsa Kurrikula e Reformuar e Kosovës kishte synim promovimin e një shoqërie multi-etnike ku respektohet diversiteti, kurrikulat u veshën me elemente ideologjike të ndryshme për fëmijët e Kosovës, varësisht se cilit komunitet ata i takonin.

Në këtë kontekst, mendoj që arti humbi një shans të mirë që në shkollë të ndërtojë ura komunikimi në mes të fëmijëve të etnive të ndryshme. duke përdorur përmbajtjet muzikore apo pamore/vizuele, vallëzimin etj.

P.sh. secili komunitet etnik, në lëndën Edukatë muzikore do të përdor vetëm muzikën popullore të etnisë përkatëse dhe literaturën muzikore Evropiane e Botërore. Poashtu në Art Figurativ, nxënësit e etnive të

ndryshme do të njohin vetëm krijimtarinë e zhvilluar nga artistët e etnisë përkatëse dhe asaj Evropiane e Botërore duke l trajtuar kryeveprat e së kaluarës. Asnjë nga etnitë e Kosovës nuk do të shfrytëzojë mundësinë që përmes artit të njohin vlerat e njëri tjetrit, sado pak. Komunitetet pakicë që janë më të integruara në Kosovë (romët, boshnjakët, turqit etj) megjithatë do të trajtojnë një pjesë shumë të vogël të krijimtarisë artistike të zhvilluar në Kosovë, kurse nxënësit e etnisë Serbe në Kosovë, do të punojnë vetëm me Kurrikulat e zhvilluara në Serbi.

Më poshtë për ilustrim do të japim një shembull nga planet dhe programet mësimore që u zhvilluan nga Kurrikula e vitit 2000 të artit muzikor dhe atij figurative të komuniteteve të ndryshme.

Edukata muzikore si lëndë mësimore në gjithë nivelin fillor dhe të mesëm të ultë (1-9) realizohet kryesisht në tre veprimtari kryesore aktive muzikore që janë 1. Interpretimi (Këndimi dhe Luajtja në Instru-

mente muzikore) 2. Dëgjimi muzikor dhe 3. Krijimi

Në secilën prej këtyre veprimtarive muzikore janë të parapara objektiva të caktuara që duhet të arrihen brenda një viti shkollor, përmbajtjet tematike dhe poashtu burimet artistike të sugjeruara nga ekspertët e lëmisë, të përzgjedhura për nxënësit e kësaj moshe dhe duke u ndërlidhur me përmbajtjet tematike. Këngët janë zakonisht këngë për fëmijë të krijuara nga kompozitorë vendorë por edhe këngë nga literatura e huaj. Burimet muzikore për dëgjim, (veprat muzikore) janë dhënë poashtu edhe nga literatura botërore e edhe nga ajo kombëtare. Edukatë Muzikore, Klasa e V-të <http://masht.rks-gov.net/planet-5?page=2> për mësimin në gjuhën shqipe.

Edukatë figurative kl V <http://masht.rks-gov.net/planet-5?page=2>

Në mënyrë të ngjashme janë paraqitur këto kërkesa edhe për klasët e tjera të nivelit fillor. Në niv-

elin e mesëm, pra të gjimnazeve, në art kryesisht praktikohet një lloj mësimi kronologjik i historisë së artit në periudha të ndryshme dhe në kontekste të ndryshme shoqërore, duke lënë hapësirë edhe për veprimtari artistike direkte, ndonëse në masë më të vogël.

Sic shihet nga shembujt, lëndët kanë vazhduar qasjen e tyre të vecantë Brenda disiplinës pa ndërlidhje në mes vete në kuadër të fushës kurrikulare artet, ndonëse ishte prezantuar në Kurrikulën e vitit 2000. Pasi u miratuan planet dhe programet, u hartuan edhe tekstet mësimore për të gjitha lëndët mësimore, pra edhe për artin muzikor dhe figurative, kryesisht të bazuara në programin mësimor.

Në Kornizën e Kurrikulit të vitit 2001 dhe në planet dhe programet mësimore janë paraparë edhe burimet artistike, mjetet mësimore dhe kushtet të cilat nevojiten për një edukim të mirëfilltë artistik. Ndonëse programet mësimore për lëndët artistike Edukatë Muzikore dhe Edu-

katë Figurative kanë dhënë hapësirë të mjaftueshme për veprimtari artistike individuale dhe kolektive në nivel të shkollës dhe të komunitetit, probleme praktike të infrastrukturës dhe të resurseve të alokuara për këto lëndë dhe shpesh realizimi i mësimin nga mësimdhënës të pakualifikuar për këto lëndë japin një pasqyrë krejtësisht tjetër të zbatimit në praktikë.

Korniza Kurrikulare e mësimin parauniversitar në 2011

Ende pa bërë një analizë të mirëfilltë për pengesat, problemet e realizimit të kësaj Kurrikule të reformuar, më 2011 rishikohet kjo kurrikulë dhe zëvendësohet më Kurrikulën e Re të Kosovës (2011) e cila ka një qasje krejtësisht të re dhe me dallime të mëdha nga e kaluara. Projekti i rishikimit është përkrahur edhe nga UNICEF dhe Komisioni Evropian përmes projektit Edu-SWAP <http://eu.eduswap-ks.org/index.html>

Tani në këtë document të ri parashihet që mësimi të jetë i orientuar kah zhvillimi i 6 kompetencave kryesore të identifikuar si të nevojshme për çdo nxënës të Kosovës.

Për të arritur këto kompetenca, të gjitha fushat kurrikulare me një qasje më të integruar të vetë lëndëve që e përbëjnë fushën kurrikulare do të duhej të kontribuojnë në arritjen e kompetencave të para, në mënyrë graduale nga viti në vit deri në arritjen përfundimtare në

fund të vitit të klasës XII.

Fillimisht janë përcaktuar qëllimet e arsimit parauniversitar:

- kultivimi i identitetit personal, kombëtar, i përkatësisë shtetërore e kulturore

- promovimi i vlerave të përgjithshme kulturore dhe qytetare

- zhvillimi i përgjegjësisë ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit

- aftësimi për jetë dhe për punë në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore

- zhvillimi i ndërmarrësisë dhe përdorimi i teknologjisë

- aftësimi për mësim gjatë gjithë jetës.

Bazuar në këto qëllime janë definuar edhe 6 kompetencat e planifikuara që ti zotërojë cdo nxënës i Kosovës, natyrisht në bazë të veçorive individuale, predispozitave dhe talentit individual të cdo nxënësi.

Figure 3.6 kompetencat kryesore Udhëzuesi për përmirësimin e praktikave në klasë dhe në shkollë

http://eu.eduswap-ks.org/Guidebooks_and_KCC/Albanian/Teacher_Guidebook_2-Pre-primary-Albanian.pdf

Kompetencat zbërthen në rezultate të të nxënës të pritura që të arrihen nga nxënësit në nivele, në shkallë kurrikulare dhe në klasë, përëmes rezultateve të të nxënës në fusha kurrikulare. Mësimi në shkollat e Kosovës organizohet përmes 7 fushave kryesore kurrikulare: 1. Gjuhët, 2. Artet, 3. Matematika, 4. Shkencat natyrore, 5. Shoqëria dhe mjedisi, 6. Shëndeti dhe Mirëqenia dhe 7. Jeta dhe Puna.

ARTET DHE EDUKIMI ARTISTIK NË KURRIKULËN E RE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR TË KOSOVËS

Në Kurrikulën e Rishikuar fusha **Artet** është e paraqitur saktë, me arsyetimin pse duhet të ketë edukim artistic, pastaj janë elaboruar konceptet që mësohen përmes arteve, vlerat, qendrimet, shkathësite artistike etj.

Fillimisht, rezultatet e të nxënit janë hartuar duke marrë parasysh gjithë trendet aktuale në edukimin artistik, përfshirë elemente të orientimit të explorimit të udhëhequr, të cituar më sipër nga Lora Bressler, me c'rast nxënësit jo vetëm që krijojnë dhe merren në mënyrë aktive me aktivitetet artistike reproduktuese ose krijuese, por edhe mësojnë për proceset artistike, mjetet shprehëse artistike dhe përdorimin e tyre, njohin vepra, kryevepra të krijimtarisë kombëtare dhe asaj botërore, mësojnë për krijuesit dhe artistët e ndryshëm.

Fusha Artet në Kurrikulën e re nuk përbëhet vetëm nga Arti Muzikor dhe Arti Figurativ si zakonisht, por këtu janë përfshirë edhe Drama e Vallëzimi, ndonëse të propozu-

ara si mësim zgjedhor fillimisht. Ndryshimi i dytë është se është tentuar qasja integrale, së paku në aspekt të temave dhe dimensioneve të rezultateve të të mësuarit, duke respektuar vecantinë e mjeteve të ndryshme shprehëse artistike që kanë në dispozicion artet e ndryshme.

Është theksuar edhe njëherë qëllimi i Edukimit artistik, në përputhje me vetë qëllimet e arsimit në Kosovë:

“Edukimi përmes arteve mundëson zhvillimin e qytetarit aktiv dhe kreativ që:

- krijon, formëson dhe merr pjesë në mënyrë aktive në ngritjen e kualitetit të jetës së tij dhe ambientit (miljeut) ku jeton.
- merr pjesë në ndërveprimin social, kulturor dhe intelektual të grupeve të ndryshme etnike, kulturore duke vënë në rend të parë aspektin njerëzor të këtij ndërveprimi.
- posedon shkathtësitë dhe aftësitë themelore teknike e krijuese

që janë të rëndësishme për punë dhe jetë” (KKK, 2011, fq39)

Jane theksuar 6 dimensione të rezultateve të të nxënësve :

1. Interpretimi, Krijimi, Performimi
2. Proceset, teknikat, mjetet shprehëse
3. Komunimi artistik dhe të shprehurit artistik
4. Të kuptuari e bashkëveprimit Art-Shoqëri-Art
5. Cmuarja dhe vlerësimi i vazhdueshëm
6. Identiteti (tet) dhe Kultura

Në secilin prej këtyre dimensioneve tregohet saktësisht se cka do të duhej të bënim në kuptim të organizmit të aktiviteteve, një-sive mësimore etj. Për realizimin e edukimit artistik brenda shkollimit të përgjithshëm është paraparë pra një bashkëpunim në mes lëndëve artistike, për të arritur rezultatet e të nxënësve të formuluarat teorikisht unike, por duke diktur se në praktikë ato diferencohen në bazë të specifikave. Në Kurrikulë specifikohen vlerat,

qëndrimet dhe skathtësitë që zhvillohen përmes arteve në edukimin e përgjithshëm:

Megjithatë këtu janë të përshkruara në mënyrë të përgjithshme për çdo lloj arti, në pjesën e rezultateve të të nxënësve për nivelin e caktuar (klasët përkatëse) zbërthehen këto shkathhtësi, qëndrime dhe vlera për secilën formë të artit. P.sh

Përpos kësaj, nxënësit do të njohin proceset artistike gjatë të cilave mjetet shprehëse artistike manipulojnë/përdoren më qëllim të krijimeve artistike sipas teknikave të caktuara në zhanre e stile të ndryshme. P.sh nxënësi mëson si përdoret vija, ngjyra, për të krijuar portret, peisazh, etj. Nxënësi mëson si ndërtohet ritmi në masa të ndryshme kohore (2/4, 3/4 etj)

Ndonëse fokusi kryesor në nivelin e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët (klasët 1-9) është në aktivitete artistike: Interpretim (këngë, lojë instrumentale, poezi, monolog, dialog, valle, mimike, pantomime etj) dhe duke realizuar këto aktivi-

tete nxënësit do të njohin edhe konceptet, proceset artistike, do t'i kuptojnë më mirë mjetet shprehëse të arteve të ndryshme dhe si mund të përdoren ato për të adresuar 6 kompetencat e parapara.

Megjithatë, nxënësit do të nxiten edhe të shijojnë veprat artistike (me dëgjim të veprave muzikore, me shikim (live ose përmes mjeteve audiovizuale) të ekspozitave, shfaqjeve, vallëzimit etj) dhe duke u nxitur që të hulumtojnë e të mësojnë më shumë për artin edhe në kohën kur nuk janë në shkollë. Ata poashtu nxiten që të vizitojnë shfaqjet e ndryshme në komunitetin e tyre, t'i organizojnë vetë ato dhe të njohin krijues, artistë, interpretues nga komuniteti i tyre, nga krijimtaria kombëtare por edhe nga thesari i krijimtarisë botërore.

Aspektet tjera kanë të bëjnë me ekspozimin e vazhdueshëm të nxënësve ndaj formave të ndryshme të artit, kultivimin e shijes artistike të mirë dhe zhvillimin e mendimit kritik artistik, që realizohet

EDUKIMI ARTISTIK SUPLEMENTAR

përmes një procesi të vazhdueshëm të vetë-vlerësimit, të vlerësimit të punës artistike të bashkëmoshatarëve (peer evaluation) dhe gjykimin, cmuarjen dhe vlerësimin edhe për veprat artistike të tjera që kanë mundësi t'i përfjetojnë.

Ja si mund të shihen në mënyrë të përmbledhur se si ndërliken 6 kompetencat e parapara për tu zhvilluar në fund të arsimit parauniversitar dhe si kontribuojnë artet në arritjen e tyre, të parapara sipas Kurrikulës së Re. Tani mbetet që institucionet përgjegjëse të zhvillojnë aspektet tjera pedagogjike e diaktike

Në Kosovë, përpos edukimit artistik që ofrohet për të gjithë nxënësit pa dallim në shkollimin e përgjithshëm, ekzistojnë edhe forma tjera alternative ku fëmijët, individët mund të zhvillojnë talentin e tyre artistik. Kjo realizohet përmes kurseve të ndryshme, shkollave jo publike artistike, projekteve kulturore, qendrave kulturore për fëmijë në qytetet e ndryshme të Kosovës.

Ekzistojnë 7 shkolla të muzikës, publike dhe disa private në të cilët nxënësit studiojnë për të mësuar luajtjen në ndonjë nga instrumentet muzikore klasike (piano, violinë, kitarë, instrumente frymore etj). Aty zhvillohet mësimi në tre nivele paralelisht me shkollimin e rregullt. Në kuadër të shkollës së muzikës, në disa qytete ofrohet edhe mësimi për balet. Ekziston një shkollë e arteve pamore në qytetin e Pejës, kryesisht si shkollë e mesme e lartë.

Ata që kanë dëshirë të zhvillojnë talentin për dramë, vallëzim, mund të vijonë programe të caktuara që ofrohe kryesisht nga operatorët kul-

PËRFUNDIM

turorë privatë.

Vlen të përmendet iniciativa e Teatrit Oda përmes projektit me të cilin kanë punuar në shkollat e përgjithshme me fëmijët e moshave 8-15 vjeç, në formë të punëtorive të rregullta javore pas të cilave prodhohet shfaqja në fund të sezonit. Kjo përvojë e mirë u jep mundësi nxënësve të talentuar për dramë, ndonëse tani edhe me Kurrikulën e Re kemi paraparë që aktiviteti i dramës në shkollë të përfshihet më shumë në kuadër të mësimit zgjedhor në bashkëpunim me lëndët Gjuhët, Artet dhe Historinë etj. varësisht nga tema e përzgjedhur.

Sfida e realizimit praktik të këtyrë formave alternative janë kostot dhe mungesa e subvencioneve nga shteti për aktivitete të tilla dhe mos stimulimi i mësimdhënësve që të realizohen në formë të projekteve në bashkëpunim me operatorët e ndryshëm kulturorë në sektorin privat.

Duke analizuar pozitën e artit në kurrikulat e shkollimit të përgjithshëm të vendeve Evropiane, shohim se mënyra si artet janë konceptuar në Kurrikulën e Kosovës janë përafërsisht me qasje të njëjtë. Qëllimet e Edukimit artistik janë të orientuara kah zhvillimi i komeptencave artistike por edhe kah realizimi i 6 kompetencave kryesore të Kurrikullitë Ri të Kosovës. Ende do të punohet në përgaditjen e mësimdhënësve për të realizuar këto kompetenca me një qasje të integruar ku edhe artet marrin pjesë.

Rezultatet e të nxënimit për fushën **Artet**, të vendosura për nivelet e ndryshme japin mundësi dhe liri mësimdhënësit që Brenda orëve në dispozicion (një orë në javë !) të mos munden të realizojnë shumë nga ajo cka kërkohet. Nëse rritja e numrit të orëve të rregullta nuk është opcion i realizueshëm, duhet të mendohen forma alterantive të mësimit zgjedhor ose projekte tematike e ndërdisiplinare ku nxënësit mund ti vënë në funksion shkathtësitë e tyre ar-

tistike për të komunikuar artistikisht mbi temat dhe çështjet e ndryshme.

MASHT dhe Drejtoritë komunale duhet të sigurojnë që lëndët artistike të realizohen vetëm nga nësimdhënësit e kualifikuar, duke filluar sa më herët që është e mundur. Edhe vetë shkollat duhet të ofrojnë një ambient stimulus artistik. Poashtu duhet të sigurojnë infrastrukturën teknologjike adekuate që nxënësit dhe mësimdhënësit të kenë mundësi që edukimin artistik ta realizojnë me sa më shumë ekspozim të shembujve të mirë artistikë nga krijimtaria lokale, kombëtare por edhe ajo botërore, përfshirë edhe vizitën në muzeume, ekspozita, koncerte si pjesë të metodologjisë së realizimit të lëndës.

Në shkollë duhet të krijohet mundësia që nxënësit ti realizojnë talentet e tyre në forma të ndryshme të artit, përtej atyre klasike që janë pjesë e kurrikulës së shkollës (p.sh fotografimi, filma të shkurtër, koncerte tematike, mjuzikell, operetta e performanca të tjera) të cilat

përfshijnë edhe mësimdhënësit e lëndëve të tjera.

MASHT dhe Drejtoritë Komunale duhet të stimulojnë më shumë shkollat për ti dhënë hapësirë më shumë punës artistike të nxënësve në shkollë dhe në komunitet përmes garave, festivaleve të posacme (p.sh garat e piktorëve, garat e koreve, ansambleve, recitatorëve etj) dhe përmes projekteve në të cilat marrin pjesë edhe prindërit dhe komuniteti. (p.sh rregullimi i oborrit të shkollës me vepra arti dhe rregullim estetik/artistik të kopshtit); puna me murale, skulptura, etj duke marrë modele të mira nga vendet në rajon dhe më gjerë.

Një mundësi e mirë është që të përdoret edhe riciklimi si veprimtari arti, pra materialet e ricikluara të përdoren për të krijuar vepra artistike në ambientet e shkollës dhe jashtë saj. Si përfundim, nxënësit natyrshëm e trajtojnë artin pjesë të jetës së tyre. Tua mundësojmë ta bëjnë këtë edhe në shkollë, duke i udhëhequr me maturi, professional-

REFERENCAT

izëm dhe dashuri.

Bresler, L. (1993). Three orientations to arts in the primary grades: Implications for curriculum reform. *Arts Education Policy Review*, 94(6), 29-34.

Bresler, L. (Ed.). (2007). *International handbook of research in arts education*(Vol. 16). Springer Science & Business Media.

Burton, J., Horowitz, R., & Abeles, H. (1999). Learning in and through the arts: Curriculum implications. *Champions of change: The impact of the arts on learning*, 35-46.

Brewer, T. M. (2002). Integrated curriculum: What benefit?. *Arts Education Policy Review*, 103(4), 31-36.

Education, A. (2009). Culture Executive Agency.(2009). *Arts and cultural education at school in Europe*.

http://eacea.ec.europa.eu/education/eurydice/documents/thematic_reports/113en.pdf

Eisner, E. W. (2002). What Can Education Learn from the Arts About the Practice of

Education?. *Journal of curriculum and supervision*, 18(1), 4-16.

Freedman, K., & Stuhr, P. (2004). Curriculum change for the 21st century: Visual culture in art education. *Handbook of research and policy in art education*, 815-828.

Graham, M. A. (2007). Art, ecology and art education: Locating art education in a critical place-based pedagogy. *Studies in art education*, 48(4), 375-391.

Hanna, J. L. (2008). A nonverbal language for imagining and learning: Dance education in K-12 curriculum. *Educational Researcher*, 37(8), 491-506.

Krug, D. H., & Cohen-Evron, N. (2000). Curriculum integration positions and practices in art education. *Studies in Art Education*, 41(3), 258-275.

Luzha, B. (2008). *Music, Politics, Identities: Comparing the Role of Music in Albania and Kosovo under the Communist Regime*. Paper

presented at the Music at all ages, ISME Conference. Bologna, Italy.

Malliarët, G. (1997). "Pedagogjia e përgjithshme. Koha. Prishtinë. MASHT. Republika e Kosovës. Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës.

<http://masht.rks-gov.net/korniza-e-kurrikules-e-arsimit-parauniversitar>

MASHT. Republika e Kosovës. Kurrikula Bërthamë e nivelit fillor (KL. I-V) <http://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/niveli-i-03-04-2014.pdf>

MASHT. Republika e Kosovës. Kurrikula Bërthamë e nivelit të mesëm të ulët (KL.VI-IX) <http://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/kb-niveli-ii-03-04-2014.pdf>

MASHT. Republika e Kosovës. Kurrikula Bërthamë e nivelit të mesëm të lartë (KL X-XII) <http://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/kb-niveli-iii-03-04-2014.pdf>

MASHT. 2012. Udhëzues për përmirësimin e praktikave në shkollë.

http://eu.eduswap-ks.org/Guidebooks_and_KCC/Albanian/Teacher_Guidebook_2-Pre-primary-Albanian.pdf

MEST. (2001). *The New Kosovo Curriculum Framework*. Prishtina: MEST Retrieved from

<http://www.masht-gov.net/advCms/documents/New%20Kosova%20Curriculum%20Framework.pdf>

Miller, J. P. (2000). *Education and the soul: Toward a spiritual curriculum*. Suny Press.

Peppers, J., Reid, E., Stylianidou, F., Walsh, P., & Young, M. (2005). The national curriculum in Kosova—a review of its first steps. London: Institute of Education, University of London.

Popovich, K. (2006). Designing and implementing exemplary content, curriculum, and assessment in art education. *Art Education*, 59(6), 33–39.

Sommers, M., & Buckland, P. (2004). *Parallel worlds: rebuilding the education system in Kosovo*. International Institute

for Educational Planning.

Sardello, Robert (1992). *Facing the World With soul*. Hudson, NY: Lindisfarne Press.

UNESCO (2015). Rethinking Education. Towards Global Common Good.

<http://unesdoc.unesco.org/images/0023/002325/232555e.pdf>

UNICEF Kosovo (2001). *The New Kosovo Curriculum Framework*. First draft.

FORUMI KULTUROR

Teatri Oda organizoi një mori takimesh informative gjatë fundvitit 2011 me qëllim të krijimit të një rrjeti të përbashkët të organizatave të kulturës në Kosovë. Në këto takime morën pjesë më se 60 pjesëmarrës, përfaqësues nga organizata të ndryshme të kulturore dhe kështu u krijua mundësia e organizimit të Kuvendit themelues, i cili u mbajt me 23.03.2012 dhe vuri themelet e Rrjetit të Organizatave të Pavarura të Kulturës – Forumi Kulturor. Kuvendi Themelues vuri themelet e Forumit Kulturor duke anëtarësuar 22 organizata të pavarura në kuadër të Rrjetit. Përmes votave demokratike u aprovua statuti, njëkohësisht u zgjodh edhe Kryesia e rrjetit. Forumi Kulturor është etnitet i regjistruar si rrjet i organizatave të pavarura kulturore si anëtare. Si sekretariat i përkohshëm i Forumit Kulturor është vendosur të jetë Teatri ODA deri në momentin e ngritjes së kapaciteteve për të formuar një Sekretariat profesional të rrjetit.

Forumit Kulturor i Kosovës është Rrjeti i Organizatave të Pavarura të Kulturës të Kosovës themeluar me qëllim të:

- Fuqizimit të organizatave të pavarura kulturore, duke i zhvilluar kapacitetet e tyre për realizimin e programeve të tyre,

- Afirmimit të organizatave anëtare,

- Përfshirjes së organizatave anëtare në proceset vendimarrëse,

- Rritjes së përkrahjes së skenës së pavarur të kulturës,

- Mbrojtjes dhe përmirësimit të pozitës së organizatave anëtare karshi institucioneve relevante të Kosovës dhe jashtë saj.

Forumit Kulturor synon të përmushë misionin e vet nëpërmjet aktiviteteve si:

- Komunikimi dhe rrjetëzimi i organizatave të pavarura në fushën e kulturës

- Shkëmbimi dinamik i infor-

macioneve dhe përvojave

- Aktivitete të lobimit dhe avokimit

- Trajnime specifike për nevojat e organizatave anëtare

- Organizimi i debateve dhe forumeve

- Bashkërenditja e aktiviteteve artistike dhe kulturore

FORUMI PËR ZHVILLIM KULTUROR

Forumi për Zhvillim Kulturor është projekt që ka për qëllim të zhvillojë më tutje dhe të forcojë Forumin Kulturor të themeluar në vitin 2012, duke ofruar këshilla dhe njohuri të vlefshme për politikën kulturore të Kosovës. Projekti është i mbështetur nga Zyra e Bashkimit Europian në Kosovë, e bartës të projektit janë Forumi Kulturor, Teatri ODA dhe DokuFest. Projekti ka filluar me aktivitetet e para në dhjetor të vitit 2013, ndërsa parashihet të zgjasë deri në nëntor të vitit 2015. Në një periudhë dy vjeçare, Forumi për Zhvillim Kulturor do të prodhojë të paktën 28 produkte të politikave të kulturës, të cilat do të rezultojnë nga hulumtime, debate, fokus grupe dhe konferenca. Projekti do të forcojë rrjetin e komunitetit të kulturës së pavarur, të ndërtojë kapacitetet e saj të brendshme dhe të ndikojë në hartimin e politikave kulturore të Kosovës përmes prodhimit të dijes për kulturë. Po ashtu, projekti do të nxisë dialogun dhe bashkëpunimin mes sektorit të kulturës së pavarur

dhe autoriteteve publike në mënyrë që të dalë me zgjidhje konkrete për zhvillimin kulturor në Kosovë.

www.forumikulturor.net



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit European në Kosovë



Implementuar nga:





forumikulturor.net
facebook.com/ForumiKulturor
twitter.com/forumikulturor